



Kuvendi i Komunës Klinë

01 Nr prot. 06-18367/2024

Datë: 05.06 /2024

Në mbështetje të nenit 12 paragrafit 12.2 shkronja (c) dhe nenit 40 paragrafi 40.2 shkronja (a) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Rregullores (QRK) numër 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, si dhe nenit 10, pikës 3 të Statutit të Komunës së Klinës, nr.01-110-1232/2010 dt.07.04.2010, si dhe me rekomandimet e KPF-së, Kuvendi i Komunës së Klinës, ne mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë: 30.05.2024 mori:

V E N D I M

1. Miratohet rregullorja për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Komunën e Klinës dhe Organogrami i Komunës së Klinës.
2. Rregullorja përcakton strukturën, organizimin, fushëveprimin, hierarkinë e raportimit dhe klasifikimin e pozitave të punës në Komunën e Klinës.
3. Pjes e këtij Vendimi është rregullorja për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Komunën e Klinës dhe Organogrami i Komunës së Klinës.
4. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohen te gjitha rregulloret komunale qe rregullojnë fushën e organizimit te Komunës se Klinës e qe janë ne kundërshtim me dispozitat e kësaj rregulloreje.
5. Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në ueb faqen e komunës së Klinës

Njoftohen:

- MAPL;
- Kryetari i Komunes;
- Zyra e Personelit në Komunën e Klinës;
- Zyra për Informim;
- Arkivi.



**Kryesues i Kuvendit
Fadil Gashi**